REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SARANDË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr.2290/12 Prot.

Sarandë, më 02.04.2026

PROÇESVERBAL

I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Sarandë që zhvillohet në sallën e Këshillit Bashkiak

Orari i fillimit të mbledhjes : 12:00
Data e mbajtjes së mbledhjes :31.03.2026
Mbajtja e mbledhjes : Salla e Këshillit Bashkiak
Lloji i Mbledhjes: Mbledhje e Radhës

Përfaqësuesit e Bashkisë Sarandë: Zv/Kryetar i Bashkisë Florjan Sali dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen.

Marrin pjesë :

1. Asaf Stroka
2. Gjergji Imeraj
3. Festim Mina
4. Zana Piro
5. Përparim Ahmeti
6. Bejdo Çela
7. Elona Mano
8. Ermir Hoxha
9. Ibrahim Bajrami
10. Ilirjan Gërdhuqi
11. Lindita Kondi
12. Dritan Peçi
13. Laureta Çeçi
14. Denisa Islamaj
15. Farie Hyska
16. Kevin Alikaj
17. Klejdjan Murtaj
18. Vesel Koçiu
19. Ilva Qëndro

Mungojnë :

20. Shpëtim Ahmeti
21. Pranvera Osmani
22. Enea Vasili
23. Angjele Lapa
24. Eugen Qëndro
25. Indi Rrapaj
26. Xhino Jaçaj
27. Thanas Gurma
28. Katerina Beqo
29. Anjeza Dike
30. Dafina Allkushi

Asaf Stroka : Përshëndetje !
Të nderuar Anëtarë të Këshillit Bashkiak! I nderuar Zv/Kryetar i Bashkisë!Të nderuar pjesëmarrës dhe përfaqësues të medias !
Zhvillojmë mbedhjen e Këshillit Bashkiak datë 31.03.2026, vijojmë bazuar në ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 53, çdo fillim mbledhje miratohet rendi i ditës sipas thirrjes për zhvillimin e mbledhjes sipas rendit si më poshtë:

1. **P/vendim** "Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6 % për muajin Shkurt 2026".
2. **P/vendim** "Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin Shkurt 2026".
3. **P/vendim**"Për miratimin e ndihmës financiare për shtetasit E. A, O.V, M. N, M. Ll, të prekur nga përmbytjet gjatë muajit Nëntor 2025".
4. **P/vendim**"Për miratimin e nisjes së procedurës së shpronësimit dhe miratimin në parim të vlerës financiare të shpronësimit për pasuritë pronë private, që preken nga projektit" përmirësimi integruar urban të zonave turistike të Ksamilit dhe zonave përreth".
5. **P/vendim** " Për korrigjimin e gabimeve materiale".
6. Raport mbi punën e Policisë Bashkiake për vitin 2025.
7. Informacion mbi ecurinë e investimeve publike në infrastrukturën rrugore,të financuara nga të ardhurat e Bashkisë dhe nga fondet e Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

Asaf Stroka: Hedhim në votim rendin e ditës .

Miratohet me 19 vota pro rendi i ditës .

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e parë të rendit të ditës: **P/vendim** "Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6 % për muajin shkurt 2026".

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 1 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Nuk ka komente diskutime

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.

Miratohet me 19 vota pro, abstenim 0, kundër 0.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e dytë të rendit të ditës: **P/vendim**"Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin shkurt 2026".

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 2 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Për këtë projektvendim u diskutua përsëri mundësi e rritjes së masës së ndihmës ekonomike nga të ardhurat e bashkisë nga këshilltarët Përparim Ahmeti, Vesel Koçiu Ibrahim Bajrami.

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.

Miratohet me 18 vota pro, abstenim 0, kundër 1.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e tretë të rendit të ditës**: P/vendim** "Për miratimin e ndihmës financiare për shtetasit E. A, O.V, M. N, M. Ll, të prekur nga përmbytjet gjatë muajit Nëntor 2025".

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 3 të rendit të ditës, kemi ndonjë pyetje nga ana e këshilltarëve?

Ilir Gërdhuqi: Në lidhje me këtë projektvendim komisioni i ekonomisë e shqyrtoi dhe ra dakort të votohet. Dua të theksoj se vlerësimin financiar të dëmeve të shkatuara u bë nga komisioni i vlerësimit të dëmeve në fatkeqësitë natyrore nga Këshilli i Qarkut Vlorë.

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.

Miratohet me 19 vota pro, abstenim 0, kundër 0.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e katërt të rendit të ditës: **P/vendim** "Për miratimin e nisjes së procedurës së shpronësimit dhe miratimin në parim të vlerës financiare të shpronësimit për pasuritë pronë private, që preken nga projektit" përmirësimi integruar urban të zonave turistike të Ksamilit dhe zonave përreth".

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 4 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Ilir Gërdhuqi: Komisioni i Ekonomisë shqyrtoi projektvendimin dhe u diskutua çështja e dëmshpërblimeve, për të cilën nuk u arrit një konsensus i përbashkët. Investimet publike janë të domosdoshme, por ne u ndalëm veçanërisht te mënyra se si është paraqitur ky projektvendim.

Duke qenë të vetëdijshëm për vlerën reale të tokave në Ksamil, vlerësojmë se çmimi i propozuar për shpronësim nuk është i drejtë.
Për këtë arsye, për momentin do të abstenoj, me qëllim që t'u jepet kohë qytetarëve të prekur të paraqesin kundërshtimet e tyre dhe që çështja të shqyrtohet më në detaje.

Përparim Ahmeti : Unë kam një pyetje, këta që preken nga ky projektvendim sa janë vënë në dijeni.

Vesel Koçiu: hiqet prona njëherë dhe pastaj vazhdohet me projektin, apo vazhdohet me projetin pastaj hiqet prona?

Garufo : Bashkia nuk ka detyrim ligjor t'i paraqesë pronarit të një pasurie njoftim në këtë fazë, pasi jemi ende në fazën e projektimit të projektit.

Momenti procedurial për të kundërshtuar vlerën e shpronësimit nuk është tani. Ky moment lind kur agjencia përkatëse të kryejë njoftimet zyrtare, në të cilin rast pronarët do të njihen me të gjithë procedurën dhe do të kenë në dispozicion mjetet ligjore për të paraqitur kundërshtimet e tyre.

Vesel Koçiu: Nuk jemi kundër shpronësimit, por është e drejtë e qytetarëve të kundërshtojnë vlerën e përcaktuar. Megjithatë, kjo mbetet përgjegjësi e ekzekutivit.

Ne jemi në mbështetje të projektit, i cili do t'u shërbejë banorëve të Ksamilit dhe zhvillimit të turizmit. Për këtë arsye, vota ime është pro.

Gjergji Imeraj: Nisur nga vlera reale e tregut dhe pozicioni gjeografik i pronës, si dhe duke qenë se sipërfaqet që do të shpronësohen (kullotë dhe truall) janë të njëjta , propozohet që çmimi për metër katror të jetë i njëjtë për të dy kategoritë. Ky çmim të jetë në përputhje me referencat e përcaktuara në VKM për truall, konkretisht në vlerën 2,560 lekë/m².

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.

Miratohet me 16 vota pro, abstenim 2, kundër 1.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e pestë të rendit të ditës: **P/vendim** "Për korrigjimin e gabimeve materiale".

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 5 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Nuk ka komente, diskutime.

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimet një nga një ,projektvendimi nr.20,nr.21,nr.22,nr.23,nr.24,nr,25,nr.26 .

Miratohen me 19 vota pro, abstenim 0, kundër 0.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e gjashtë të rendit të ditës:

Raport mbi punën e Policisë Bashkiake për vitin 2025.

U zhvilluan diskutime

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 6 të rendit të ditës, kush ka pyetje nga ana e këshilltarëve?

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e shtatë të rendit të ditës

Informacion mbi ecurinë e investimeve publike në infrastrukturën rrugore,të financuara nga të ardhurat e Bashkisë dhe nga fondet e Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

Kjo pikë e rendit të ditës u shty dhe do të shqyrtohet në mbledhjen e muajit prill.

Asaf Stroka : Duke ju falenderuar, e deklaroj mbledhjen të mbyllur.

Ky proçesverbal mbyllet me nr.rendor 5(pesë) fletë, i cili pasi verifikohet firmoset nga kryetari i këshillit, sekretari i këshillit dhe komisioni i verifikimit të procesverbalit.

Mbajtësi i proçesverbalit: Valbona Vasili

Komisioni i Verifikimit të Proçesverbalit :

1.	Kryetar i Këshillit Bashkiak :	Asaf Stroka
2.	Partia Socialiste e Shqipërisë:	Lindita Kondi
3.	Partia,Drejtësi,Integrim dhe Unitet:	Klejdjan Murtaj
4.	Partia Balli Kombëtar:	Bejdo Çela
5.	Partia Republikane Shqiptare :	Përparim Ahmeti
6.	Fryma e Re Demokratike:	Ilir Gërdhuqi
7.	Kryetar i Grupit Bashkë Fitojmë:	Shpëtim Ahmeti
8.	Kryetar i Grupit Partia Demokratike:	Vesel Koçiu
9.	Aleanca Arbnore Kombëtare:	Xhino Jaçaj
10.	I pavarur	Kevin Alikaj